

Gjuha e Thjeshtë

Mbrojtja e përfituesve të Caritas Kosova

Udhëzues



Falënderojmë anëtarët e shoqatës
Klubi Dëshira

Grupi Kontrollues:

Lumnije Demolli

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi

Qëndrim Jashari

Blerta Krasniqi

Qëndresa Krasniqi

Shefqet Sinani

Sokol Hamiti



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

ëëë.inclusion-europe.eu/easy-to-read

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

Shënim: Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Cartias Austria.

Informacione të rëndësishme për përfituesit e shërbimeve të Caritas Kosova



Caritas Kosova u ofron ndihmë personave që kanë nevojë.



Ndihma që ofron Caritas Kosova është pa pagesë për të gjithë ata që marrin shërbime.



Për Caritas Kosovën të gjithë njerëzit janë të barabartë.

Të gjithë njerëzit duhet të kenë të njëjtën mundësi.



Ke të drejtë të pyesësh për çdo gjë që të intereson rreth punës së Caritas Kosova.

Ke të drejtë të **ankohesh** për punën e Caritas Kosova.

Ke të drejtë të marrësh përgjigje.



Asnjë punëtor i Caritas Kosova nuk ka të drejtë të kërkojë nga ti:


- shërbim,
- të mira materiale (produkte, mallra),
- apo para

Gjërat e rëndësishme që fëmijët duhet të dinë

Punëtori i Caritas Kosovës nuk guxon:



- të të godasë ty,
- të të bërtasë ty,
- të të prekë,
- të të bëjë të ndihesh keq ose të të fyejë,
- të të çojë vetëm në veturë,
- të të ftojë në shtëpinë e tij/saj.



Nëse ndonjë punëtor i Caritas Kosovës të bën diçka të keqe ose të lëndon, tregoja një personi që i beson.



Nëse punëtori të thotë që mos t'i tregosh askujt për atë që ndodhi, mos e dëgjo!

Tregoja një personi që i beson.

Siguria jote është më e rëndësishme.



Tregoju prindërve ose kujdestarëve të tu nëse dikush të lëndon apo

Tregoju nëse dikush të prek në një mënyrë që nuk të pëlqen.



Tregoju të gjitha këto edhe shokëve dhe shoqeve tuaj!

Si të dërgosh një ankesë?

Caritas Kosova ka një udhëzues për mbrojtje.




Caritas Kosova ka një punëtor që merret me ankesa.

Nëse dikush të lëndon ty apo të shkel të drejtën tënde, duhet të shkruash një **ankesë**.



Vetëm punëtori që merret me ankesa do t'i dijë të dhënat e tua personale.

Të dhënat personale janë:



- emri dhe mbiemri,
- adresa e banimit,
- numri i telefonit,
- adresa e e-mailit.



Punëtori për ankesa nuk guxon t'i japë të dhënat e tua askujt tjetër.



Nëse ke një pyetje ose dëshiron të ankohesh, mund të flasësh me personin përgjegjës për ankesat në këto mënyra:

- Vendose ankesën në kutinë që gjendet në zyrën e Caritas-it.
- Telefono në numrin: +38349
- Dërgo një e-mail në adresën:

safeguardingofficer@caritaskosova.org

Mars 2023						
X	2	3	4	5	6	
7	8	9	10	11	12	13
14	X	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Caritas Kosova ka për detyrë të japë përgjigje për çdo pyetje ose ankesë që dorëzon, brenda një afati prej 30 ditësh.



Caritas Kosova ndodhet në Ferizaj, në rrugën Shën Nënë Tereza 3, (Kisha Katolike).



Zyrat e Caritas Kosova janë të hapura nga ora 08:00 deri në 16:00, nga e hëna deri të premtën.



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/qNbXxNhhXtiRCxh9>



**CARITAS
KOSOVA**

Përgatitur: Caritas Kosova www.caritaskosova.org /
383 (0) 290 328 110 info@caritaskosova.org
Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike
70000 Ferizaj, Kosovë